



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIVJAKË  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Divjakë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje bazë materiale për mobilimin e shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39290000-1 Mobilime të ndryshme, (CPV): 39100000-3 Mobilje, (CPV): 39112000-0 Karrige , 39132100-7 Dollapë organizimi dosjesh, 39292100-6 Dërrasa të zeza, 39121200-8 Tavolina, 39122000-3 Dollapë dhe rafte librash.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 3 109 662 (tre milion e njëqind e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa Tvsh, nga Granti i ardhur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Llogaria ekonomike 231.**

Burimi i financimit:

**Ky fond është parashikuar nga Granti i ardhur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Llogaria ekonomike 231.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Divjakë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar dhe nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me

qëllimin kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

#### **2.1.1 Sipas Shtojcës 7, pika 1 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit"**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, si edhe në nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

*(Shënim: përcaktimi nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2021, 2022 dhe 2023 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2 germa c dhe pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM Nr.285/2021 "Kerkesat për kapacitetet ekonomiko financiare", pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në piken 2/c citohet: 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence", ndersa në piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu vendosja e kriterëve në reference është bere që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, në nenin 43 pika 1, pika 2 germa c dhe pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i

ndryshuar, ne Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma c, të Nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023.

*Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

**Shënim:** Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është bërë në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën e cilësisë **ISO 9001- 2015** ose ekuivalente (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë); e cila duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijë objektin e prokurimit, për rastet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është prodhues i mallit. Për rastet kur operatori ekonomik pjesëmarrës nuk është prodhues i mallit duhet të paraqesë një vetëdeklarim në të cilin të deklarojë se furnizuesi është konform standarteve të cilësisë.

*(Certifikata si më sipër, duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)*

Vendosja e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë. Paisja me këtë certifikatë ISO, garanton që OE konkurues plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve ushqimore që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 44, pika 1, të VKM nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e*

*cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit., si edhe ne Ligjin nr.116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se Çertifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që AK të krijojnë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer shërbimin objekt kontrate. Ne lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikaten e standartit si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në propocion me te, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i ISO-s rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojnë konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rastin kur është importues i mallrave objekt prokurimi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për produktet objekt kontrate, ku të percaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vertetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e mallit dhe kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve në rast defekti, brenda periudhës së garancisë. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/foto ose skeda teknike për mallrat që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimeve përkatëse sipas të dhënave në DST, të përkthyer në gjuhën shqipe në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike, të mallrave objekt prokurimi.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë transportin dhe montimin e mallrave në shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë, brenda afatit të parashikuar.

**Argumentim:** Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-se që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të percaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

- 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetëdeklarim garancie për një periudhë 1-vjeçare për mallrat që kërkohen të prokurohen nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen, zëvendësimin dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër se mallrat objekt prokurimit janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara si dhe marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimi ose riparimi, mirëmbajtja dhe shërbimi pa pagesë.

*Shënim: Autoriteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:*

### **2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

#### **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**


*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve:

### 1. Tavolinë nxënësi cikli i ulët - (120 x 64 x 45 cm)



- Syprina MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht, duhet të ketë trashësinë më të madhe ose të barabartë me 18 mm, me veshje laminatë në mënyrë që të durojë gërvishtje. Montimi i syprinës me skeletin duhet të bëhet me vida të fshehta ose me perçina me kokë Ø4.
- Në pjesën e poshtme të saj të jenë të vendosura një element me permasa 110x26 cm MDF e melaminuar 16mm dhe e frezuar perimetralisht, që shërben për mbajtje të librave të nxënësve.
- Montimi i syprinës me skeletin të bëhet me vida të fshehta.
- Në pjesën ballore të vendoset një element me permasa 110x14.5cm me material MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht.
- Këmbët vertikale duhet të jenë me profil tubular oval ku në të dyja anet e tubit të jete i rrumbullakosur, që të japi fortesinë dhe imazhin e dukshëm të tavolines, me seksion jo më të vogël 50x25mm dhe spesor jo më të vogël se 1.2 - 1.5mm. Pjesa fundore do të jetë me profil tubularoval ku në të dyja anet i rrumbullakosur jo më të vogël se 50x25mm, me spesor jo më të vogël se 1.2 - 1.5mm. Pjesa e harkut, duhet të jetë me profil tubular me seksion jo më të vogël se 20x20mm, spesor jo më të vogël se 1.2 - 1.5mm, e lyster me boje elektrostatische ngjyrë sipas kërkesës së klientit. Në fundet e tyre të kenë tapa plastike për shmangien e zhurmave të ndryshme.
- Preferohet ngjyra e metalit e zezë ose gri.

*Vërejtje: Shmangiet lejohen 5% nga të dhënat që janë vendosur në specifikime*

### 2. Tavolinë nxënësi cikli i lartë - (120 x 75 x 45 cm)




- Syprina MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht, duhet të ketë trashësinë më të madhe ose të barabartë me 18 mm, me veshje laminatë në mënyrë që të durojë gërvishtje. Montimi i syprinës me skeletin duhet të bëhet me vida të fshehta ose me perçina me kokë Ø4.
- Në pjesën e poshtme të saj të jenë të vendosura një element me permasa 110x26 cm MDF e melaminuar 16mm dhe e frezuar perimetralisht, që shërben për mbajtje të librave të nxënësve.
- Montimi i syprinës me skeletin të bëhet me vida të fshehta.
- Në pjesën ballore të vendoset një element me permasa 110x14.5cm me material MDF e

melaminuar dhe e frezuar perimetralisht.

- Këmbët vertikale duhet të jenë me profil tubolar oval ku ne te dyja anet e tubit te jete i rumbullakosur, qe te japi fortesine dhe imazhin e dukshem te tavolines, me seksion jo më të vogël 50x25mm dhe spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm. Pjesa fundore do të jetë me profil tubolaroval ku ne te dyja anet i rumbullakosur jo më të vogël se 50x25mm, me spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm. Pjesa e harkut, duhet të jetë me profil tubolar me seksion jo më të vogël se 20x20mm, spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm, e lyer me boje elektrostatische ngjyrë sipas kerkeses se klientit. Në fundet e tyre të kenë tapa plastike për shmangien e zhurmave të ndryshme.
- Preferohet ngjyra e metalit e zezë ose gri.

***Vëretje: Shmangiet lejohen 5% nga të dhënat që janë vendosur në specifikim***

### **3. Tavolinë nxënësi dyvendëshe – Arsimi i Mesëm - (120 gjatësi x 45 gjerësi x 75 lartësi cm)**




- Syprina MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht, duhet të ketë trashësinë më të madhe ose të barabartë me 18 mm, me veshje laminatë në mënyrë që të durojë gërvishtje. Montimi i syprinës me skeletin duhet të bëhet me vida të fshehta ose me perçina me kokë Ø4.
- Në pjesën e poshtme të saj të jenë të vendosura nje element me permasa 110x26 cm MDF e melaminuar 16mm dhe e frezuar perimetralisht, qe sherben për mbajtje të librave të nxënësve.
- Montimi i syprinës me skeletin te bëhet me vida të fshehta.
- Në pjesën ballore të vendoset nje element me permasa 110x14.5cm me material MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht.
- Këmbët vertikale duhet të jenë me profil tubolar oval ku ne te dyja anet e tubit te jete i rumbullakosur, qe te japi fortesine dhe imazhin e dukshem te tavolines, me seksion jo më të vogël 50x25mm dhe spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm. Pjesa fundore do të jetë me profil tubolaroval ku ne te dyja anet i rumbullakosur jo më të vogël se 50x25mm, me spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm. Pjesa e harkut, duhet të jetë me profil tubolar me seksion jo më të vogël se 20x20mm, spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm, e lyer me boje elektrostatische ngjyrë sipas kerkeses se klientit. Në fundet e tyre të kenë tapa plastike për shmangien e zhurmave të ndryshme.
- Preferohet ngjyra e metalit e zezë ose gri.

***Vëretje: Shmangiet lejohen 5% nga të dhënat që janë vendosur në specifikime.***




#### 4. Tavolinë mësuesi cikli i lartë,arsimi i mesëm - (120 x 60 x 76cm)



- Suprina të ndërtohet me melamine me trashësi 25mm me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave.
- Përmasat e suprinës të jenë 120x60cm.
- Veshja perimetrale e të gjithë elementëve përbërës të saj të jenë PVC 0.8mm.
- Pjesët anësore të jenë të të njëjtit material me përmasa 70x60cm dhe me spesor 18 mm.
- Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues dhe me tapa për të shmangur gërvishtjet me parketin ose pllakat.
- Bashkimi i suprinës me këmbët bëhet me aksesore të padukshëm.
- Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë dhe të paktohet që të mos dëmtohet gjatë transportit.

*Vëretje: Shmangiet lejohen 5% nga të dhënat që janë vendosur në specifikime.*

#### 5. Tavolinë nxënësi dyvendëshe për kompjuter – Arsimi i Mesëm



- Përmasat e tavolinës për Desktop:
  - Syprina 1400 x 700 x 750 mm
  - Skeleti 1350 x 650 x 725 mm
- Dy çengela që ndodhen nga brenda për të varur çantat e nxënësve.
- Syprina e punës: Melaminë 18 mm e boeduar me PVC 0.8 mm dhe që del mbi skelet.
- Skeleti është i ndërtuar me profil metalik tubolar me seksion katror 30 x 30 mm, me spesor jo më të vogël se 1.2 - 1.5 mm, këmbët metalike janë të pajisur me vida rregullimi lartësie për të siguruar një nivel horizontal të pavarur nga mosnivelet e dyshemesë.
- Nën syprinë majtas ose djathtas është elementi mbajtës i njësisë qendrore e bërë me material melaminë 18 mm me përmasa: 500 x 250 x 600 mm.
- Ngjyra metal.
- Prodhim, furnizim dhe montim.

#### 6. Karrige nxënësi cikli i ulët - (35 x 38 x 37/70 cm)



- Mbështetëset dhe ulëset të jenë me material frezilit, i derdhur në të gjithë trupin e ndenjtes dhe të shpines. Materiali i derdhur i frezilitit duhet të jetë i qendrueshëm kundër lagështirës dhe gërvishtjeve. Ndenjtësia dhe shpina të jenë të harkuara (me gropa në qendrën e ulëses dhe në forme anatomike).
- Skeleti duhet të jetë me profil tubolar oval ku në të dyja anet e tubit të jetë i rrumbullakosur, që të japë fortesinë dhe imazhin e dukshëm të karriges, me seksion jo më të vogël 30 x 15mm dhe spesor jo më të vogël se 1.2 - 1.5mm.

I gjithë skeleti të jetë i salduar me saldim të vazhduar me argon dhe i lyer me bojë elektrostatiqe, në pjesët fundore të ketë tapa plastike.

- Ndejtësia dhe shpina është kusht i domosdoshëm për implementimin e kontratës.

#### 7. Karrige nxënësi cikli i lartë - (35 x 38 x 42-45/75 cm)

- Mbështetëset dhe ulëset të jenë me material frezilit, i derdhur ne te gjithë trupin e ndenjtes dhe te shpines. Materiali i derdhur i frezilitit duhet te jete i qendrueshem kunder lageshtires dhe gervishtjeve. Ndenjtësia dhe shpina të jene te harkuara (me gropa në qendrën e ulëses dhe ne forme anatomike).



- Skeleti duhet te jete me profil tubolar oval ku ne te dyja anet e tubit te jete i rumbullakosur, qe te japi fortesine dhe imazhin e dukshem te karriges, me seksion jo më të vogël 30 x15mm dhe spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm.
- I gjithë skeleti të jetë i salduar me saldim të vazhduar me argon dhe i lyer me bojë elektrostatiqe, në pjesët fundore të ketë tapa plastike.
- Ndejtësia dhe shpina është kusht i domosdoshëm për

implementimin e kontratës.

#### 8. Karrige nxënësi, arsimi i mesëm - (35 x 38 x 42-45/75 cm)



- Mbështetëset dhe ulëset të jenë me material frezilit, i derdhur ne te gjithë trupin e ndenjtes dhe te shpines. Materiali i derdhur i frezilitit duhet te jete i qendrueshem kunder lageshtires dhe gervishtjeve. Ndenjtësia dhe shpina të jene te harkuara (me gropa në qendrën e ulëses dhe ne forme anatomike).
- Skeleti duhet te jete me profil tubolar oval ku ne te dyja anet e tubit te jete i rumbullakosur, qe te japi fortesine dhe imazhin e dukshem te karriges, me seksion jo më të vogël 30 x15mm dhe spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm.
- I gjithë skeleti të jetë i salduar me saldim të vazhduar me argon dhe i lyer me bojë elektrostatiqe, në pjesët fundore të ketë tapa plastike.
- Ndejtësia dhe shpina është kusht i domosdoshëm për implementimin e kontratës.

#### 9. Karrige për mësues me tapiceri - (510 x 450 x 780 mm)



- Shpina dhe ulësja të jenë të bera me plastikë te zezë, rezistente ndaj goditjeve, të mbushura me sfungjer te cilesise se larte me dendesi 40kg/m3, i ngjitur me lëndë ngjitëse, për të krijuar formën ergonomike, dhe të veshura me tekstil (tapiceri).
- Pjesa e poshtme e ulëses dhe e pasme e shpinores mbulohen me kapak plastik të së njëjtës formë.
- Përmasat e ulëses të jenë: 450x400mm, ndërsa të shpinores të jenë 300x450 mm.
- Lartësitë e ulëses dhe shpinores të jenë përkatësisht 400-460mm dhe 700-750 mm.


- Struktura mbajtëse të jetë e përbërë prej profil çeliku oval me përmasa 30x15mm, me spesor jo me te vogel se 1.2 mm, i harkuar me kalnder.
- Kjo strukturë tëjetë e salduar me argon ose shkarkesë elektrike dhe e lyer me furrë elektrostatische.
- Fundet e këmbëve të kenë tapa plastike të trasha 5mm për të qenë jetëgjatë në përdorimin e tyre.
- Ngjyra e karriges të jetë sipas dëshirës së klientit.

#### 10. Dollap për klasa – (90 x 45 x 185cm)



- Përmasat: jo më pak se 90x45x185cm.
- Materiali i perdorur do te jete melamine me trashesi jo me te vogel se 16 mm, bordet anesore te se cilit jane te veshura me material plastik pvc me spesor jo me te vogel se 0.8mm.
- Pjesa e pasme e dollapit është e përbërë me fibër me trashësi jo më pak se 3mm.
- Të ketë 2 kanata me hapje 90°, doreza e brava me çelës.
- I gjithë dollapi mbështetet mbi këmbë plastike me lartësi 6 cm.
- Pjesa e brendshme e dollapit do të ndahet në 4 hapësira të barabarta me anë të 3 sergjenave.
- Lart dhe poshtë do të ketë shula për fiksimin e kanateve.

#### 11. Raft për bibliotekën – (90 x 40 x 185 cm)



- Rafti është i disenjuar për bibliotekë.
- Faqet vertikale janë me melaminë me trashësi 1.8 cm me veshje perimetrale të plastifikuar me PVC 0.8 mm.
- Rafti ka gjithësej katër ndarje horizontale të brendshme. Ndarëset horizontale të raftit janë melaminë 25 mm me veshje perimetrale të plastifikuar me PVC 0.8 mm.
- Trashësia prej 2.5 cm dhe gjatësia e lirë prej 90 cm është një gjatësi optimale e cila siguron hapësirë të mjaftueshme, gjithashtu ruan qëndrueshmërinë dhe nuk deformohet nën veprimin e ngarkesës së librave me kalimin e kohës. Faqja e mbrapme e raftit është me përbërje fibër me trashësi 3 mm. Montimi do të realizohet me aksesore të fshehur. Prodhim, furnizim dhe montim në shkollë.


#### 12. Raft/Dollap për zyra (90 x 45 x 185 cm)



- Skeleti dhe sergjenet do jenë prej materiali melamine me trashësi 18 mm. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8mm. Poshtë fiankeve do ketë këmbëza me mekanizë nivelues. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej materiali melaminë, me trashësi jo më të vogël se 1.8 cm që mbyllën me çelës.
- Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjeni me lartësi të regjistrueshme. Pjesa e sipërme është e mbyllur me kapakë xhami me /ose pa korniza. Hapësira brenda kapakëve të xhamit do ndahet në tre hapësira me anë të dy sergjeneve.

- Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës. Prodhimi, Furnizim dhe Montim me shkollë

### 13. Dërrasë e zezë (120 x 180 cm)



- Të dhënat teknike të saj janë: Mënyrë tradicionale e paraqitjes, shkruhet me shkumës. Sipërfaqe e lyer me ngjyrë të zezë ose jeshile, e lehtë për t'u fshirë falë strukturës ekstra të imët të sipërfaqes. Sipërfaqe jo gërvishëse dhe rezistente ndaj acideve. Ngjyrë e zezë ose jeshile mat me sipërfaqe jo reflektuese.
- Dorëzimi të bëhet duke përfshirë mbajtësen e shkumësave dhe kompletin e montimit.

- Përmasat totale: 120 x 180 cm.

### GRAFIKU I LËVRIMIT TË MALLIT

Artikulli	Përshkrimi	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Tavolinë nxënësi cikli i ulët (120x64x45 cm)	45	Shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë	60 ditë
2	Tavolinë nxënësi cikli i lartë (120 x 75 x 45 cm)	30	Shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë	60 ditë
3	Tavolinë nxënësi dyvendëshe, arsimi i mesëm (120 x 45 x 75 cm)	16	Shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë	60 ditë
4	Tavolinë mësuesi cikli i lartë, arsimi i mesëm (120 x 60 x 76cm)	10	Shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë	60 ditë
5	Tavolinë nxënësi dyvendëshe për kompjuter për Arsimin e Mesëm Syrina ( rreth 1400x700x750 mm) Skeleti (rreth 1350x650x725 mm)	10	Shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë	60 ditë
6	Karrige nxënësi cikli i ulët (35 x 38 x 37/70 cm)	41	Shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë	60 ditë
7	Karrige nxënësi cikli i lartë (35 x 38 x 42-45/75 cm)	40	Shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë	60 ditë
8	Karrige nxënësi, arsimi i mesëm (35 x 38 x 42-45/75 cm)	30	Shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë	60 ditë
9	Karrige për mësues me tapiceri (510 x 450 x 780 mm)	30	Shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë	60 ditë
10	Dollape për klasa përmasa (90x45x185 cm)	18	Shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë	60 ditë
11	Raftë biblioteke (90x40x185 cm)	15	Shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë	60 ditë
12	Raft/Dollap për zyra (90x45x185 cm)	20	Shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë	60 ditë
13	Dërrasë e zezë (120x180 cm)	30	Shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, Bashkia Divjakë	60 ditë

*\* Shënim: Në respektim të nenit 36 të LPP-së, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.*

Specifikimet teknike u hartuan nga komisioni për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit, caktuar me Urdhërin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Nr.238, me Nr.4635 Prot, datë 07.06.2024 duke u bazuar në shkresën e dërguar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me Nr.1668/217 Prot, datë 07.03.2024 dhe protokolluar në Bashkinë Divjakë me Nr.1638 Prot, datë 08.03.2024 me lëndë “Për blerjen e pajisjeve të mobilerisë për shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm”, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar, Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Neni 12, Neni 13 dhe Neni 76.

### **NJËSIA E PROKURIMIT**

